

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

834-1  
557

# LLAZAR SILIQI

# JU FLET TIRANA

VJERSHA DHE POEMA


8sh-1

557-

LLAZAR SILIQI

# JU FLET TIRANA!

vjersha dhe poema



34695

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## M E S A Z H I

*Poemë.*

### 1

Buzën shkrumbuar njomi te burimi,  
ballin djersitur flladi ia freskoi.  
Mes gjetheve dëgjohej shushurimi  
e rriddhte  
si mendimet  
kroi.

Nga vapa përvëluese u freskua,  
në vend të bukës ai u ngop me ujë,  
një lisi iu afrua,  
një çast qëndroi i ngrirë si një statujë.

Lart ngriti kokën edhe u mbush me frymë.  
Dhe i foli vetes:  
— Sulu me fërtymë,  
se erdhi dita e madhe e Shqipërisë!  
Përmes stuhisë  
rrugën e vet mesazhi i ri ka nisë...

Vrapon djaloshi ditë e natë pa u ndalë,  
në buzë —  
të shtrenjtën fjalë.  
Ai ec e ec...  
Por rruga është e gjatë.  
Gjatë rrugës kà errësirë e ka shtrëngatë.

Vë veshin.  
Është mesnatë.  
Vajtojnë me ligje nëpër shekuj gratë  
me lot të nxeh të,  
që grijnë dhe shkëmbin.  
Ai ec  
me plagët ndër pusi e luftra marrë, —  
më shumë i dhëmbin  
plagët e trimave ndër shekuj rënë.  
Nuk di çka do të thotë të hiqesh zvarë.  
Ia ka ngarkuar legjendaren barrë  
më legjendarja Nënë.

Ai ec e s'flet.  
Ec pa u ndalë një herë...

Ai, ndoshta, serën nxirrte në minierë,  
porse në rrugët e Atdheut të vet  
këmbët i nguleshin  
në baltë.

Ai, ndoshta, minator  
vagonat me qymyr i shtynte me krahror,  
në gjoks i futej vdekja e ngadaltë.

Ai malin mund që grryente me mundim,  
çimentoja të derdhej nëpër thasë,  
dhe vetë  
vështronë me trishtim  
si në shtëpinë —  
kartona e teneqera, shpartallinë —  
murlani i hynte nga çdo plasë;  
po kur shikonte një patrullë  
qytetit  
me këmishëzinjtë milicë,  
thellë e pushtonte  
zemërimi,  
nga zjarri i urrejtjes s'ndiente ngricë.

Mbase në gji të detit bëhej qull,  
rrahë nga stërkalat,

për të zënë pak peshk;  
për një ikupë ujë burimi,  
nga ujt' e kripur,  
kishte rreshk.

Ai kishte rreshk për ujë e për liri.

Ndoshta diku në malësi,  
në kullë,  
i mbyllur në vetminë  
tragjike,  
ai vuante tmerrsisht,  
sepse po zbehej kënga e lashtë epike,  
se luftë tash burrat bënin me urinë,  
që brinjët ua kafshonte egërsisht;  
tokën shterpuar e mihte me thonj,  
pak misër që të mbillte për fëmijë.

Ndaj u shkëput nga vatra si shkëndijë.  
Ndaj doli të shkallmojë  
këta vargonj.

Ai,  
ikushedi,

në një shtypshkronjë,  
ku edhe dita ish e mugët  
e kishte lagështirë edhe në verë,  
duke radhitur «Nënën» kishte ndier  
se ia kish zënë gjithë rrugët  
një ulkonjë  
gjithmonë e uritur,  
duke zgjedhë germat për «Vargjet e lira»  
kish ndier se duheshin këputë zinxhirat  
edhe i qe ndezë dëshira  
të ngrinte kryet prej kasave të plumbit,  
të çante me krahë shqipesh në stuhi  
e tej me krahët e pëllumbit  
të sulej lart në kaltërsi.

### Ai

kish lindur përsëri  
në një shtëpi qerpiçi të Tiranës.  
N'atë natë Nëntori  
të vitit Nëntëqind-Dyzetenjë  
një diell i ri ish ngritur lart për të.

Në jetë më kurrë nuk do të ecte anës.  
Do të ecte drejt  
me hap prej punëtori.

Qëndronte roje.

Brenda

një Burrë kish mbledhur shokët kokë më  
kokë,

hulli të re kish nisë të hapë parmenda,  
një farë e re ish hedhur mbi këtë tokë.

Atë Burrë në jetë s'do ta harronte kurrë,  
biseda e tij në shpirt do i rridhte gurre  
guximi e shprese e hovi e sigurie.

— Mbaje mend, djalosh, këtë natë!

Si komunist lufto, si të ka hije!

Qysh sot mund të përballësh çdo shtrëngatë.  
Përbindsha t'egër n'udhën tënde rrinë?...

Përpara ec!

Qysh sot kemi Partinë!

#### 4

Dhe ai ec.

Në buzë —

një fjalë të rrallë

nga dhei, mbrujtë me gjak e djersë, buruar,  
nga ylli pesëcepash frymëzuar,

një jetë të tërë të dëshëruar.

Në dorë të sigurt duhet dhënë mesazhi!

Kokën armiqve le t'ua fshehë blindazhi... .

Trimat  
me vdekjen  
kqyren ballë për ballë.

Ai s'ishte një.

Ish një e ish dyqind.  
Ai bir i Shqipërisë ish në çdo ind,  
në zemër — yllin flakë-e-gjak,  
ishte më i riu maratonomak.

5

Po agon.  
Në ag  
vështron:  
si pjalm përhap kjo erë e çmendur shkrumbin  
kah ngrihet nga kasollet mes lajthive,  
që zjarr u vunë  
xhelatët e hordhive,  
sepse për ta kasollet patën plumbin,  
për partizanët — bukën e fëmive.

Tradhtarët le t'u bien fort daulleve  
e le të cirren para megafonëve

fashistë edhe të shitur!...  
Në këmbë ne jemi ngritur,  
në luftrat për liri jemi kalitur, —  
në çdo lugine,  
çdo kryqëzim të udhëve  
do u presim kokë e bisht autokolonave.  
E shenjtë edhe e paprekshme është kjo tokë,  
kështjellë që s'jepet është çdo prag.

Me trëndafila lufta s'bëhet, shokë!  
Ajo fitohet  
me vuajtje dhe gjak.  
Për një liri të tillë këndoijnë bilbilat,  
nga gjaku i kuq  
të kuq mbijnë trëndafilat,  
që lëshojnë gonxhe për të gjitha kohët.

Po perëndon.  
Gremisen rrokopujë armiqtë në hon,  
kënga e hakmarrjes nëpër fshat gjëmon,  
Atdheut përhapet anembanë...

Dhe u puthën katundarë e partizanë  
mbi hasmin dufin si e nxuar.  
Dhe tha djaloshi:  
— Kështu armiku do dërmuar,  
që mos t'i shtrijë më kurrë t'egrit çaponj!

Në një shtëpizë ngujuar — tre heronj.

Ata s'janë kordhëtarë.  
 Është trimëria e popullit shqiptar,  
 që burra i bën,  
 të brejnë çelik me dhëmbë,  
 përballe armikut të luftojnë në këmbë,  
 një me njëqind të dalin fitimtarë.

Për komunistët s'ka rrethim pa dalje!  
 Dhe për rrethuesit kobëzinj s'ka falje!

Djaloshi  
 trimave u vajti pranë  
 dhe tok të katër këngën e filluan...  
 Në Shkodër krisi pushka a në Tiranë,  
 bombat në Korçë, apo në Vlorë gjëmuan?..

Për komunistët s'ka rrethim pa dalje!  
 Për ecjen tonë,  
 për ecjen tonë  
 s'ka ndalje!

Prej zemërimit reaksi<sup>n</sup>i plasi,  
disfata e t<sup>ë</sup>rboi.

Se pushka partizane rreptas krisi  
e ai doli i gjallë,  
në gji mesazhin rrasi,  
i lirë si zogu i shqipes fluturoi,  
vrapimin legjendar ai prapë e nisi.

Ai s'ishte një.

Ish një e ish një mijë.

~~Ishte shkëndijë~~

që ndez të kuqen flakë.

Ai ish  
trim midis trimave ndër maratonomakë.

Ai ec.

Nuk ec, — ai fluturon si shpes.

Para vështirësive kurrë nuk tkurret.

Mes predhave pa drojtje turret,  
çan lumin e t<sup>ë</sup>rbuar mes për mes.

Lumin kaloi...

Ndoshta qe Vjosa,  
ndoshta qe Shkumbini,  
Erzeni, Semani, Valbona a Drini.  
Secili lumë, patjetër, do rrëfejë  
për një kalim mes dimrit,  
një betejë,  
për kuajt e ushtrisë thundrapërpjetë,  
helmetat,  
që i merr rrjedha për në det.  
Secili lumë, patjetër, do tregojë  
për partizanët me këngët në gojë,  
për trimin e paemër,  
**që çau përmes acarit dimëror —**  
**një pushkë në dorë,**  
**një amanet në zemër.**

Ai ec.

**Nuk** ec, — ai fluturon si shpes.  
Në këtë mëngjes  
si dre u ngjitet shpateve të malit.  
Me lende lisi ai urinë e shuan,  
etjen — në gjurmë të kalit.

Mbi male rrezet dielli i shprazi,  
kreshtat e Arbërisë  
**krenare u zgjuan...**

Në cilin mal vrapimin do ta ndali?  
Në cilën majë duhet shpënë mesazhi?

Kah Mali i Skënderbeut drejtimin mori,  
apo drejt Çikës ec ai ditë e natë?  
Mali i Kokojkës ndoshta e pret?  
Tomori?  
Ndoshta Gramozi, apo Mali i Thatë?  
E pret Korabi a, ndoshta, Veleçiku?...

Një plumb i armikut ballin ia fshiku.

Por djali s'ndalet.  
Gjakun fshin në ballë...  
Ai s'mund të vdesë! Duhet të mbesë i gjallë!

8

Dhe iu kujtua ajo ditë e rrallë,  
kur ai me shokë pruri në mal  
grupet e shkronjave ndër thasë ngarkuar.

U ndal.  
Ishte Ai vetë!

Ish Burri i atij Nëntori në Tiranë,  
që ngriti një Parti  
për ne — flamur i ri,  
trumbetë,  
tmerr për tiranët anembanë.

Ai barrën vetë ia zbriti fill në tokë,  
me të u përfal me gaz të patreguar  
dhe ndenjën fort të përqafuar,  
si më të vjetrit shokë.

Ajo ngarkesë — më e shtrenjtë se një thesar,  
në të —  
ëndrra për dritë e popullit shqiptar.

Ndaj Burri e ngriti peshën e rënduar  
sikur të ngrinte një fëmijë në duar.  
N'atë thes të vrazhdët ishin brenda  
shkronjat për fjalët që do vinë.  
Në sup e hodhi,  
germat qenë të rënda —  
mbi shpatulla Ai mbante historinë...

Kjo erë e historisë  
ç'po fryn nga mali!...

Rreh palët mbi një shkëmb të lartë flamuri,  
që dora e fortë e Partizanit nguli.  
Rreth një trapeze krejt prej guri  
gjithë të pavdekshmit  
Kastrioti i uli,  
nga Naim Frashëri te Ismail Qemali,  
te Çerçiz Topulli e Dedë Gjo' Luli...

Përfytyrimin ia përflaku  
Teodori elbasanas, Naum Bredhi...  
— Mbi germat, shokë,  
prapë gjaku  
le të rrjedhi! —

E ata mendoi  
që i ndoqi sharja, shpifja e shkishërimi,  
që i priti plumbi, thika dhe helmimi.  
Vështroi  
karvanet varg të qiraxhinjve,  
rojet brimuese të kufijve,  
pa abetaret fshehë ndër bakërhane  
dhe poezitë — në torbat e tagjive, —  
më e mira shujtë  
për tryezat e fëmive.  
Janë këto fjalë të shqipes — jatagane,  
në zheg të robërisë janë shatërvane,  
nën fron të tiranisë — gjithmonë vullkane.

Nën degë të bredhave, përbri një kroi,  
një fjalë e re zjarr-e-kushtrim gjëmoi.

E shkroi

Taras e Malo e Shpati e Valbona,

e shkruan

heronjtë ndër shekuj,

mëmat,

malet tonë.

Edhe u shtyp fjala, që krijon tërmete,  
mes maleve të larta në një shpellë.

Djaloshi do ta shpinte ndër qytete

në ilegalitet të thellë,

këtë fjalë djaloshi do ta conte

në çdo kasolle,

në të rreptat fronte.

Ndër zemrat njerëzore duhej mbjellë!

Jehojnë hareshëm malet arbërorë,  
mbi male rrezet dielli i shprazi.

Dhe iu shndërrua trimit tonë në dorë

në një flamur të kuq

mesazhi.



Malet vështroi dhe i thanë:  
«Djalosh, vrapo!»  
Te lumi hodhi sytë: «Vrapo!» tha lumi.  
«Tej, djalë, uria, lodhja, etja, gjumi!».  
«Shpejto!» i thanë  
trimat nga shtrati i vdekjes ngritur.  
«Shpejto!» i thanë fëmijët  
nga plumbat e nazistëve kositur.  
«Shpejto!» i thanë dhe shokët partizanë  
përpara sulmit,  
në mes të pllajës në Brigadë radhitur.

Uria e grryen?  
Veten nuk e jep.  
Plumbat në trup?  
Nga dhembja s'mblidhet kuspull.  
Ai sulet pyll më pyll e shkrep më shkrep,  
ai endet nga qyteti në qytet,  
në dorë mesazhin ai e mban  
si 'busull.

Ai s'ishte një.

Ish një e njëqind mijë.  
Ishte shkëndijë  
dhe flakë.

Ai ishte populli i tërë  
më njësh i bërë  
në luftë kundër armiqve shtazarakë,  
një popull nëpër shekuj luftëtar,  
tashti —  
i s'ardhmes triumfuese lajmëtar.

## 10

Me ditë e net ai ecte pa u ndalë,  
në buzë —  
të rreptën e të drejtën fjalë  
nga dora e Enver Hoxhës shkruar,  
nga Shtabi i kryengritjeve besuar,  
nga shekujt urdhëruar.

Ecte.

Në dorë  
shtrëngonte fort mesazhin.  
Ecte krenar mbi truallin e vet.  
Ai për armiqtë e dritës është shauret.  
Për Shqipërinë — tallazi,  
që fshin handraqet nga ky dhe.

Për Shqipërinë ai është një këngë e re.

Në vend të litanive të klerikëve

e mykut të kondikëve,  
shpërthejnë  
prej faqeve të Historikëve:  
më e zjarrta kumë,  
që i këndon himne luftës për liri,  
blerimi i ndeztë e lulet ngjyrashumë  
selitur anembanë në Shqipëri —  
një uzinë,  
një institut,  
një dashuri...

Dhe do ta sillte këtë mesazh patjetër  
të pastër  
përmes vitesh heroike  
n'atë ditën shkëlqimplotë të lirisë,  
kur do të niste Epopeja tjetër  
e bukur,  
e mundimshme,  
titaniqe  
drejt ëndrrës më të shtrenjtë të njerëzisë.  
Dhe do të bëhej Republika e re  
në tokë e qiell e det — barazh.  
Do udhëtonte prapë nëpër Atdhe  
ky i pavdekshëm,  
frymëzues  
mesazh.

Mesazhi për tërë jetën do kumtonte  
beteja pas betejash të lavdishme.

Do të kumtonte  
si Republika lart ndër horizonte  
fener do ngrihej dhe e mrekullishme,  
në rruzull e nderuar,  
e fuqishme,  
si e Drinit të përrallshëm energjia  
do i ndizte dritat nëpër Shqipëri,  
Metalurgjia  
do rritej ditë për ditë me krenari.

Do të kumtonte  
të naftës gurgullimën e nëndheshme,  
kodrinat, që do gdhenden me brezare,  
ëndrrën e tokës për të qenë e plleshme,  
me ujë të ngopur — tokën tonë shqiptare,  
moçalin çerdhe e vdekjes — të kulluar,  
dheun gjithë arna-arna — të bashkuar,  
djerrishtën shekullore — të lëruar,  
Lulin e vocërr — n'Universitet,  
në OKB — djaloshin komissar,  
Heroin e Punës — deputet

dhe gruan — në llogoren më të parë,  
flamujt e lirë mbi flotën tonë detare,  
të artit  
më të pastërtat ugare.

Do të kumtonte  
një popull fort të kapur dorë për dorë,  
në çdo Njëzetenëntë Nëntor  
ushtrinë gjithmonë e më të armatosur,  
dështimet e armiqve të krekosur,  
dërmën e turpin për rrufjanët  
dhe lumin popullor nga të gjitha anët,  
që derdhet me furi  
në detin e fuqisë që s'njeh kufi,  
drejtimin e sprovuar të timonit,  
triumfin e Revolucionit.

## 12

Buzën shkrumbuar njomi te burimi,  
ballin djersitur fllađi ia freskoi.  
Mes gjetheve dëgjohej shushurimi  
e rridhte  
si mendimet  
kroi...

Te kroi lajmëtari, si u freskua,  
një lapidari iu afrua,  
një çast qëndroi i ngrirë statujë.

Ai — një Mujë,  
përftim i ëndrrës shekullore  
për forcën e pandalshme viganore,  
që edhe lisat shkul e botën bind.  
Ai, ndoshta, lindë në Krujë,  
në Gjirokastër, ndoshta, lindë.

Përherë ndër vite — ballë i barrikadave.  
Ai — maskëçjerrësi i superfuqive  
e shpartalluesi i bllokadave,  
i lajkave,  
demagogjive,  
shantazheve e komploteve,  
pabesive.  
Për Fordët dhe Brezhnevët — grusht i fortë.  
Mashtrues e agresorë ai kamzhikon,  
por mikun  
buzagaz e pret në portë.

Ai — flaka lart e ngritur me hare,  
ai — Socializmi që marshon,  
populli vetë — i madh edhe i përjetshëm,  
i gjerë e rrënjosjellë e i gjithpushtetshëm,  
më faqendrituri ndër maratonomakë,  
që fton  
për drejtësi e për çlirim mbi dhe.

Ai është sgalemi i furtunës,  
që do të shembë një botë stërplakë,  
është këngëtari i punës  
dhe luftëtari i Botës së Re.

Shokë, ndër beteja na thërret trumbeta!

Që dhei të njomet,  
të mëkëmbetjeta,  
s'mjafton një vrizëm  
e shiut në pranverë...

Lipset

rrëkeja e dlirojë marksizëm-leninizëm,  
flamuri të valojë në ballë përherë,  
në dorë të sigurt të kalojë stafeta!

Me ditë e net,  
me muaj e me vjet  
ai ec dhe do të ecë pa u ndalë,  
në buzë gjithmonë —  
të madhërishmen fjalë.

## TË DASHURIT E MI . . .

Të dashurit e mi...  
Vitin e Ri — gëzuar!  
Përherë të lirë, të lumtur, të bashkuar!

Me llamba lart mbi diga shkruar,  
n'ekranet e televizorëve.  
ndër buzë,  
ndër zemra,  
n'ajër —  
një fjalë e ngrohtë si fjalët e dashnorëve,  
një fjalë flurore e plot hare: gëzuar!  
Në punë e jetë ky vit i ri — me hajër!

Gëzuar gjithë të lumturuarve  
në çdo betejë,  
në të përditshmet fronte,  
gëzuar gjithë atyre, që edhe sonte  
punojnë  
a armët s'i lëshojnë prej duarve,

që tej vështrojnë në katër horizonte,  
gëzuar gjithë të dashruuarve!

### Gëzuar

të bardhëve, të verdhëve a zezakëve,  
gëzuar gjithë atyre që mes flakëve  
hidhen,  
që flaka e lirisë të ndrisë,  
në llum armiqtë —  
dinakët, të pabesët, zemërliqtë,  
helm e dënim për ta!

Ata —

ujq që janë gati shokun ta kafshojnë,  
netët s'ua ndrit një xixëllonjë,  
ata —

skllevër të arit.

Ne —

punën shpallim kryezonjë,  
vëllezër e mburojë për shoqishojnë,  
yjet e flaktë na frymëzojnë  
ndër shtigjet e Pesëvjeçarit.

Dhe na rrëmben  
hareja,  
që shpërthen  
kur vdes e vjetra, triumfon e reja,  
hareja,

që ecim pa u ndalë në tokën tonë shqiptare,  
që pulsi i jetës rreh natën dhe ditën,  
hareja kur ne sytë na përshkënditen  
ndër festa nga shpërthyeset fishekzjarre,  
hareja marramendëse e shpejtësive,  
e kapërcimit të vështirësive, —  
vetë lumturia, shokë, është luftëtare!

Një vit u mbyll,  
por na sëmbon në zemër  
për çdo gëzim të shuar,  
për çdo zotim pa plotësuar...  
Egon e cmirin e shpirtvogëlsinë,  
zvaritjet e burokracinë —  
nën thembër!  
Në gostinë tonë të parët le t'afrohen  
ata që ecin në një hap me kohën,  
të rinjtë e revolucionarët!  
Në gostinë tonë — larg fjalët e venitura,  
fjalët e plogëta e mjegullore,  
fjalët që pikojnë vrer!  
Këtu kanë vend veç fjalët e kalitura,  
fjalët me aromë të tokës arbërore,  
fjalët si bari i njomë kur vjen pranverë,  
fjalët si ai thëllimi fshikës,  
si era e shëndetshme e autokritikës.

Të dashurit e mi,  
Vitin e Ri — gëzuar!.

Po ç'është ky shqetësim,  
ky zemërim si dallgë në kraharuar?...

Midis urimeve «gëzuar»  
më hyri fjala koskëdalë «shfrytëzim»,  
më hyri dhelpërisht fjala «mashtrim»,  
më hyri fjala e egër «bombardim»,  
një nënë m'u shfaq e lebetitur,  
statujë e dhembjes së nemitur,  
me foshnjën vrarë në duar.

Përfytyrimet  
zhytë ndër dritëhije  
më feksin herë atje e herë këtu...  
Vështroj tash:  
flokë-flokë dëbora bie  
e ndër ballkone pragjet zbardhon pjalmi...  
Po ç'është kështu?

Lëkurën pa mëshirë ma djeg napalmi.  
Të rintjtë këndoijnë,  
të rintjtë dancojnë — në vesh urojnë «gëzuar!»  
E jona është kjo jetë e gjallëruar,  
nuk është e jonajeta e plogtë,  
e murmë!

Të rintjtë këndoijnë,  
të rintjtë dancojnë,  
për dashurinë lart ngrihet tromba...  
Po ç'është kjo zhurmë?...  
Shpërthejnë mbi këngën bomba.  
Mes thirrjeve të ndritshme «hej, gëzuar!»  
në vjershë shpërndarë si lule të shumngjyr-  
shme,  
më hyjnë të errta thirrjet« hesht», «në burg»,  
hipokrizitë mbi djersën derdhur çurg,  
lakeu revizionist me buzë të lyrshme,  
që llup, lakmie ndezë, në një tryezë  
me të pangopshmin Kapitalizëm.

Të dashurit e mi,  
Vitin e Ri — gëzuar!  
Përherë të lirë, të lumtur, të bashkuar!  
Bashkuar  
me një urejtje dhe një dashuri  
në çdo hare e në çdo çast të hidhur,  
me një Parti për jetë a vdekje lidhur,  
me dashuri të njëjtë për të,  
që pas çdo prove bëhet më e gjallë,  
po me një yll në ballë,  
me zemrat e vullnetet bërë një,  
me hovet e me shpresat bërë një,  
me duart në një pluar,



## **DHE SHUSHURIMA E FSHEHUR E BURONJAVE**

Rrëzë pyllit natën — prushi i xixëllonjave  
dhe shushurima e fshehur e buronjave.

Diku —  
rrahja e fletëve të shkabonjave.

N'agim — e papërshkrueshmja simfoni e  
zogjve,  
yje përflakë në ballë të sogjeve,  
me armët ditë e natë në duar,  
blerimi,  
që të merr përjetë në gji,  
një lapidar nga rrezet i ndriçuar,  
një trëndafil me vesë...

Në zemër — kroje e dashuri.

Me Atdheun  
jam i lidhur besa-besë.

## KËNGËT E PAVDEKËSISË

1

Në një gosti,  
nuk di se ku,  
vloj kënga «Eja mblidhuni këtu!»

Dhe m'u përflak imagjinata...

2

Të rinj,  
që i ndez për lufta t'reja demostrata.

Këmishëzinj,  
që drita e diellit tremb më shumë se nata.

3

Kur ranë,  
ndër demostrata a partizanë,  
dëgjuan, ndoshta, zërat e fëmijve,  
që rrugës sot kalojnë duke kënduar...

Ndaj  
jo më kot  
i mbyllën sytë të dëshëruar  
ta lenë këtë vend në të sigurta duar,  
t'u ngjiten brezat lartësive,  
t'i rriten shqipes të fuqishme fletët.

Ata e dinin:  
gjallë Partia mbetet  
e Shqipëria vatrën e ka plot.

4

Këtë tokë  
s'e njomi nëpër shekuj vada.  
Ujët qe i pakët, pikë edhe flori...

Për ta begatë, e derdhën gjakun shi  
luftarët;  
e, kur ranë për këtë liri,  
në varre s'hynë, —  
zunë vend nëpër balada.

5

Motra e vëllezër, dilni prej baladave!  
Në dorë rrëmbeni  
shamitë e kuqe të Brigadave  
e mes valltarëve ndër dasma eni!

6

E në na thirrtë boria e alarmeve,  
do të na gjeni  
syrin pishë pranë armëve,  
me ne —  
e dimë —  
do suleni mbi armikun vetëtimë,  
të gjallë në ballë të luftës do të jeni.

Ndër shekuj — veç në ballë, o trima, ju!  
Ndër shekuj — «Eja mblidhuni këtu! »

Motra e vellezér, dilni prej baladave!  
 Sot në gostinë e re  
 gazmorë ju eni  
 e tundni me hare  
 mes brohorisë  
 shamitë e paharrueshme të Brigadave!

Pastaj  
 prap ktheni,  
 mbi këto vargje hipur si mbi kuaj,  
 në vendin tuaj —  
 në këngët e pavdekësisë.

## KËNGA E PUSHKA

*Përpara violinës së Qemal Stafa*

Ç'ëndërr kish e ç'brengë violia?  
Çfarë premtimi kish  
poezia  
n'ato vite të rinisë, Qemal?...  
Dridhej harku lehtë prej malleve  
e trishtohej prekë prej hallevë...  
Por një Diell po ngrihej përmbi mal.

Tinguj t'rinq lëshoi violia.  
Pushkë në dorë të dha  
Partia.  
Kënga e pushka nuk t'u ndanë, Qemal!  
Larg nga çdo trishtim, prej vajeve!  
Të lartoi shqiponjë të majeve  
Komunizmi — i madhi ideal.

## **MONOLOGU I VETERANIT**

Unë me thinja i kam flokët  
edhe ballin gjithë me rrudha,  
por nuk ndahem  
kurrë  
nga shokët,  
por nuk shmangem  
kurrë  
nga udha,  
nuk më lodh marshimi i gjatë,  
nuk më ndal shtegu i vështirë,  
nuk më tremb asnje shtërgatë,  
mes furtunës  
ndihem mirë.

Ndihem mirë në tokën mëmë.

Për këtë tokë  
çdo gjë që bëmë

ne përherë na duket pak.  
Kush na e prek,  
të gjallë s'e lëmë!  
Gati jem' të derdhim gjak!  
Mbi këtë tokë, ku sonte flemë,  
vdekjen gati jem' të gjejmë, —  
të rrojë mëma Shqipëri!  
Në këtë vend krenarë ne jemi,  
lumturinë këtu e kemi,  
gjejmë këtu bukë e liri.

Për këtë tokë  
gjyshërit tanë,  
gjithë ata që vendin lanë,  
në kurbet të hidhur vanë,  
patën brengë e patën mall  
për një rrugë të ngushtë të shtrembër  
n'atë qytet dikur me emër,  
për një këngë,  
një kupë me dhallë,  
për një mal me borë ngarkuar,  
për një pushkë në dorë shternguar,  
për lirinë të sakatuar  
nga një mbret katil,  
zuzar,  
për këtë popull shqipëtar,  
q'ish i varfér,  
por bujar,

q'ish i shtypur,  
por krenar,  
në gjoks — shpirtin luftëtar.

Ndihem mirë në tokn' e lirë,  
ndihem mirë nën qiell të dlrë,  
hapin hedh të lehtë — të lehtë,  
Nga ky qiell i dlrë përjetë  
do të zbresë veç shiu i mirë,  
që i begat gjithë arat tonë.  
Në këtë qiell të dlrë përjetë  
do lëshojnë fëmijtë balonat,  
do të çajnë porsi shigjetë  
krahëshpejtët tanë —  
avionat.

Ndihem mirë midis rinisë,  
me të rinjtë rri kuvendoj.  
Me rininë e Shqipërisë  
kënga e re  
na rrjedh si kroi...

Është kjo këngë për ty, o popull,  
nga Vermoshi gjer në Dropull,  
është kjo këngë për Republikën,  
që armikut s'ia ka frikën,

me armikun — dhëmb për dhëmb,  
Është kjo këngë për ty, o popull,  
mendjelartë e zemërshkëmb,  
që stuhia nuk të tremb,  
se ne lindëm mes furtunës,  
ne u rritëm mes furtunës,  
mes furtunës u kalitëm,  
si furtunë mbi armiqtë u ngritëm,  
gjithë në ballë Partinë e Punës.

Është kjo këngë për ju, o male,  
për të lartat ideale,  
për ata,  
që jetën dhanë  
nëpër male — partizanë,  
ndër qytete — ilegalë,  
nëpër kampe — zemërvalë,  
para vdekjes veç dy fjalë:  
«Rroftë liria!»

Vlon kjo këngë —  
brezi i ri të mos njohë brengë,  
të punojë i lirë përherë,  
t'dashurojë i lirë përherë,  
të këndoja i lirë përherë.

Kënga jonë vlon sot për detin,  
që buçet me brohori,  
për bashkimin,  
unitetin,  
për njeriun tonë të ri.  
Është kjo këngë për ty, Parti!

Ti, Parti,  
baba dhe nënë,  
ti na rrit e na vë fletë,  
na mëson të ecim vetë,  
të sigurtë ta kemi zënë.  
Ti për ne gjithmonë — flamuri,  
dielli ynë, Parti, ti je,  
këngën populli ta thuri —  
ta këndoje fëmija e burri  
nëpër rrjedhë të shekujve.  
Të sulmojmë na ke mësuar,  
të përballim çdo tallaz,  
të jetojmë  
duke u rinuar  
dhe të vdesim buzagaz.  
Ti për ne je frymëzimi,  
krenaria,  
gazi ynë,  
kur ti flet, flakron mendimi,  
zemra çelet,  
flladi fryn.

Ndihem mirë midis rinisë,  
me të rintjtë rri kuvendoj.  
Me rininë e Shqipërisë.  
me filizat e Partisë  
kënga e re  
na rrjedh si kroi...

Kurrë  
në krahët e dëshprimeve !  
Bashkë në motet e gjëzimeve,  
bashkë mes zhurmës së gjëmimeve!

Pushkët tona partizane!  
Pushkët tona partizane!  
Në dëborë e në tufane  
nëpër sulmet çlirimtare  
s'ju lëshuam kurrë prej dore,  
me ju shkuam  
në fitore!  
Pushkët tona partizane,  
që amanet heronjtë na i lanë,  
ndrijnë në duart punëtore,  
ndrijnë në duart e fshatarëve,  
shkëlqen Koha e Pesvjeçarëve,  
është prapë Koha e Komisarëve, —  
pranë çdo kazme  
pushka pranë.

Ne marshojmë,  
marshojmë,  
marshojmë.

Hapin rrahim në paradë  
e flamurët lart i çojmë  
nga Brigada në Brigadë.

Ne marshojmë,  
marshojmë,  
marshojmë  
edhe himni i Ushtrisë jehon.

Ty përjetë, Atdhe, të mbrojmë!  
Ty të mbrojmë, Revolucion!

Vrulli ynë është proletar,  
hapi ynë është i përpiktë,  
radha jonë është e çeliktë,  
syri ynë është sogjetar.

Fjalët tona janë të ndershme,  
armët tona janë të tmerrshme,  
urratë tona — të potershme,  
kur në sulm vrapojmë të parë  
sypatremburit ushtarë,  
komandantë  
e komisarë.

Me armë mbushur gjithnjë rrimë,  
sypafjetur, —

ne e dimë  
lumi flë e hasmi s'flë!  
N'grykë të pushkës kush na vë,  
n'grykë të topit ne e vëmë,  
gati jem' të derdhim gjak.  
Për këtë tokë  
çdo gjë që bëmë  
ne përherë na duket pak.

## SADO TË RRJEDHIN VJETËT. . .

*poemë*

*Në Dhomën e Lavdisë të repartit  
ushtarak, që mban emrin e Bri-  
gadës së 1-rë Sulmuese.*

### I

Unë jam ushtar i ri.  
Nga ç'krahinë vi,  
nga ç'fshat a shkollë a profesion,  
s'ka rëndësi.

Më thirri në këtë vjeshtë  
një fletë e thjeshtë —  
rroben e blertë  
të vesh unë menjëherë,  
që vendi ynë  
të gjelbërojë pareshtë,  
një fletë e thjeshtë,

që befas më kujtoi se tanimë  
jam burrë,  
se kurrë  
asnjë rrebesh  
në rrugë dot s'më ndalon.  
E thellë në shpirt  
një ndjenjë ajo më ngjalli —  
të bardhë  
si lart mbi male e bardha borë,  
që zemrën thellë ma dallgëzoi  
si det,  
që bëri fill të më djersitet balli  
nga ndjenja e  
përgjegjësisë së rëndë —  
të rëndë si malet,  
të shenjtë porsi betimi  
i partizanit  
përmbi tokën gjakvaditur,  
të vrullshme  
si përrroi malor, që s'di të ndalet,  
dhe frymëzuese si zotimi  
i metalurgut ballëndritur.

Një fletë më thirri,  
që më filladiti si puhi fytyrën,  
që më kujtoi detyrën  
që ka ndaj prindit biri,  
një fletë —

dëshmi —

se jam i fortë e i ri,  
se biri yt jam edhe unë, Parti,  
se jam i denjë  
me armë t'i dal zot jetës,  
se jam dhe unë  
mburojë e së vërtetës,  
se jam një bir i mirë i kësaj toke,  
se jam i lirë,  
se për lirinë  
jam gati  
të derdh gjakun bashkë me shokët.

Më thirri në ushtri, —

jo  
që të bëj karrierë e të vë grada,  
por që të ec n'atë udhë  
që më shënoi Brigada,  
që emrin ia dha repartit tim, —  
më thirri  
zemërkalituri e faqendrituri  
Revolucion,  
më thirri në ushtri  
e shtrenjta,  
e dhembshura,  
e drejta,  
krenarja e trimëresha mëmë  
Shqipëri.

## II

Unë jam ushtar i ri.  
Në Dhomën e Lavdisë  
mendueshëm rri.

Dhe janë aty  
të gjitha frymëzimet —  
në Dhomën e Lavdisë!  
Dhe duan frymëzimet  
një shkëndizë,  
që të na ngrohin me një flakë  
vigane,  
ashtu si dimrit zjarret partizane.

Dhe më pushtojnë vegimet,  
një këngë më ndizet  
për lavdinë e madhe.  
Fjalm' e Enverit pret  
Brigada e Parë  
dhe vlon t'i nisë marshimet  
sa më parë.

Unë shoh  
Vithkuqin,  
Xhyrë apo Symizë,

një Tendë të Qypit,  
Pogradec a Prezë,  
që do ta mbajnë ndër mote flakën  
ndezi.

Shikoj  
kolonat partizane  
përmes ngricës,  
autokolonën djegur në Derven,  
nën Urën e Moglicës  
kërmat fashiste  
vala i rrëmben,  
si vala nëpër shekuj ka rrëmbyer  
të gjithë armiqjtë,  
të liq e të ndërkryer,  
vala e mërisë së popullit  
në këmbë,  
që rob s'rron dot, barutin ha me dhëmbë.

Shikoj  
dëborën, erën dhe stuhitë,  
që ngrijnë gjymtyrët,  
vagëllojnë të parit,  
kalimin e lumenjve mes acarit,  
marshimet  
të uritur

ditë  
e natë,  
po s'kthejnë nga rruga, —  
rrugën çajnë me shpatë,  
po s'kthejnë nga rruga, —  
veç përpara shkojnë,  
me shoqishojnë  
të lidhur besa-besë,  
tmerr për armikun  
e për popull shpresë.

Shikoj  
Brigadën  
që ia beh ku derdhet gjaku,  
ku rreptë sulmojnë  
Gjokë Doçi e Karadaku,  
ku mitralozi grin e gjëmon topi,  
të bukrën partizane Penelopi,  
Netën, të paharrueshmen heroinë,  
gjithë trimet,  
që nderuan Shqipërinë.

Përfytyroj  
parakalimin në Berat,  
në Tendë,  
midis luftimeve,

mes simfonisë burrërore  
të gjëmimeve —  
nderimin e kujtimit të Leninit,  
në një ditë maji —  
hedhjen e Shkumbinit,  
marshimet  
grykë më grykë e shpat më shpat,  
dymijë-dyqind-e-gjashtdhjetë  
kilometrat,  
korrierët,  
që për Shtabin shpien letrat,  
korrierët këmbëshpejtë,  
këmbëpërgjakë  
dhe tym e flakë  
në strofkën e armiqve  
në Tiranë,  
përleshjet  
ditë e net — plot nëntimbëdhjetë...  
Çdo rrugë e çdo shtëpi e lanë  
me gjak,  
me popull tok i ngritën  
barrikadat,  
se një janë populli edhe brigadat,  
Tiranës  
ata i hoqën çdo handrak,  
varrosën shokët  
trimat partizanë,

pastaj  
të lodhur e të lumtur  
thellë ofshanë,  
me popullin  
e ndezën bashkë duhanë.

Përfytyroj  
dyqind luftimet nëpër Shqipëri,  
nëpër beteja rritur — një rini  
me yll të kuq në ballë  
e këngë në gojë,  
luftare e një Brigade pararojë.  
Dhe numëroj  
treqind e shtatëdhjetë dëshmorë  
emër për emër,  
Lirinë e Komunizmin —  
thellë në zemër,  
nazistë fodullë e tradhëtorë —  
nën thembër.

Ua bënë armiqve trimat  
jetën varr.  
Brigada e Parë —  
stuhi që s'mund ta ndalësh.  
Ndër gryka malesh  
ende jehon britma e Brigadës:

«Zjarr!»

Brigada —

dallgë, kur zë trazohet deti.

I rreptë e i dashur —

komandant Mehmeti.

Ja! Rri ai mbi tankun e nazistikit,

rri edhe merr shënime —

shkëndijë

për më të flaktat frysëzime,

për këngën e lavdisë

së Komunistit.

E gatshme edhe sot Brigada jonë

në të lodhshmet marshime,

në stërvitje,

në këngë e në mësim e në kalitje.

Brigada jonë

gjithmonë

do mbesë —

tmerr për armikun

e për popull shpresë.

Unë jam ushtar i ri.

Në Dhomën e Lavdisë

mendueshëm rri...

Dhe ka aty

kushtrime dhe fitore,  
buste dhe përmendore,  
që brezave kujtimin t'ua lemë,  
kujtim që nuk venitet —  
për çdo mëmë,  
për çdo armik  
flakë, batërdi e gjëmë.  
Dhe është aty  
e vrazhdë dhe heroike — Historia.  
Dhe flatrat rreh aty mbi ne —  
Lavdia.

### III

Në Dhomën e Lavdisë dëgjoj  
një këngë...

Kush

në mes heshtjes po këndoka vallë?  
Kush po ia thotë  
me aq brengë  
e zjarr  
e mall?

Janë shokët,  
janë heronjtë — sërish të gjallë,  
ata që ranë

për Nënteqind e Dymbëdhjetën,  
që u hodhën përmbi tela  
në Njëzetën,  
ata që u sulën partizanë  
edhe flamurin ngritën anembanë  
më 29 Nëntor Dyzetekatër,  
që s'ëndërruan tjetër  
veçse të lirë  
me popull të këndonin,  
veç të bashkuar të parakalonin.

28-29 Nëntor...

Çdo mot edhe çdo ditë  
me armë në dorë.  
Dy data të bashkuara, binjake,  
dy gjuhët e një flakë,  
dy shpatet e një mali,  
plaku Ismail,  
djaloshi i ri Qemali,  
epokat e lavdisë së këtij dhei  
gjer te Enver Hoxha,  
që stuhinë shpërtheu.  
Ndër mote —  
vuajtje e mall e brengë,  
ndër mote —  
kryengritje, krisma, këngë,  
përmbi dëshmorët një flamur,

vajtim pa lot i nënës luftëtare,  
një heshtje burrash  
edhe një batare...  
Liria shqipëtare —  
një lule e kuqe mbirë mbi gur.

Në Dhomën e Lavdisë  
këngë përsëri, —  
është kënga  
e ushtarit më të ri.  
Në Dhomën e Lavdisë  
betimin bëj,  
me grushtin lart në ballë,  
ushtar besnik të jem  
sa të jem gjallë.

Sado të rrjedhin vjetët,  
beto hemi  
të ruajmë amanetët,  
që nëpër shekuj lanë  
të urtët,  
të rreptët,  
zemërplasurit stërgjyshët tanë,  
të ndihemi gjithnjë  
trashëgimtarë  
të atyre burrave shqiptarë,  
që një i patën

veprat  
edhe fjalët,  
që para sulmit t'egër të hordhive,  
para vërshimit të tallazeve,  
braktisën egërsinë e hasmërive  
e hidhërimin e marazeve  
dhe ngulën vend  
radhitur si vargmalet.

Sado të rrjedhin vjetët,  
betohemi  
të ruajmë amanetet,  
që duke vdekur lanë  
për shekujt  
të pavdekshmit partizanë,  
të jemi luftëtarë  
si trimat e Brigadës sonë të Parë,  
ta kemi si ajo shpirtin sulmues,  
grushtin ta kemi si ajo dërmues,  
si ajo — guximin,  
papërkulshmërinë,  
kur vapa djeg a suferina shfryn,  
si ajo —  
gatishmërinë  
të japim edhe jetën  
për dheun e Arbërit,  
për të vërtetën,

që mbron në botë Atdheu ynë,  
të nderojmë Nënën,  
që na ka dhënë sisë,  
të jemi  
bij të denjë të Shqipërisë,  
pavdekësia e Partisë.

## FËMIJËT TANË

Me dritë na i mbushën sytë dhe këngët  
përherë fëmijët tanë.

Për ta më shumë përveshim mëngët,  
për ta s'rrimë kurrë mënjanë.

Për ta godasim jetn' e vjetër,  
që plogtas ec rrëshqanë,  
dhe ngrejmë për ta ne një botë tjetër  
me drapër e çekanë,

një jetë të re — gjithë me shpërthime,  
pa shtypës e tiranë,  
një jetë me këngë e fluturime,  
me sulme anembanë.

## VIJNË NËNAT LUFTETARE...

11 Qershori —  
i shumëprituri,  
gazmori,  
n'qytet të lindjes po më fton.  
Nga kraharori  
si krua  
një këngë e re më gurgullon...

Dhe m'u kujtua:

Në Shkodër.  
Burgu.  
Brenda nëna e re  
priste fëminë — ta mbushte me hare  
në atë qeli fashiste të trishtuar,  
t'ia davariste n'qiell të zymtat re...

Oh, ç'm'u kujtua çupkëza Nevenka,  
kufoma e njomë mbështjellë me pelenka,

pa lindur —  
me burgim të rëndë dënuar,  
e lindur —  
midis mureve rrëthuar,  
në burg e vdekur — për të akuzuar  
fashistët dhe tiranët shpirtkatranë,  
tradhtarët,  
klerikalët anembanë —  
me lot prej krokodili qaramanë,  
që të qajnë ditën, natën po të vranë.

Ç'm'i ndezi vargjet nëna luftëtare,  
që para armikut lot s'lëshoi fare,  
fjalët e urejtjes  
i lëshoi  
batare!

Vijnë nënati luftëtare  
në Kongres —  
ato që s'u përkulëa mes furtunës,  
ato që ndër Brigada shkrepëtinë —  
të luftës dhe të punës,  
që e shumuan Shqipërinë,  
që ruajnë  
me kujdes  
të rriten brezat të shëndetshëm,

të jetë Atdheu i lirë edhe i përjetshëm,  
më i ri të bëhet në çdo brez.

Vijnë gratë  
me dekoratat radhë në krahuar  
dhe një flamur  
shtrëngojnë në duar.  
Dhe vjen flamuri dorë më dorë  
qysh nga ilirianet gjer te Marigoja,  
nga Margarita  
te shoqet sot — mendimet si dëborë,  
te gratë e sotme — zemrën si deboja,  
të BGSH-esë lavdia,  
pararoja.

Parakaluan gratë para tribunës —  
të dashurat,  
që jetën zbukurojnë,  
që gati janë këtë jetë të re ta mbrojnë,  
të qeshurat,  
që s'ia përtojnë kurrë punës,  
të lindurat në drithë e në liri.  
Jo mbetë pa shkollë, —  
me dituri!  
Jo zbehë nën ferexhe, —  
plot me shëndet!

Jo sypërmbywsura, —  
gjithë dinjitet,  
luftare për emancipim të plotë,  
shembull frymëzimi për shumë gra në  
botë!

11 Qershori —  
i shumëprituri,  
gazmori,  
i sulmeve të reja promotori,  
Kuvendi i shqiponjave me fletë,  
që vigjëlojnë përjetë,  
që normat bashkë me ne n'uzina thyejnë,  
ndër ara mbledhin duaj,  
godasin rreptë me ne çdo gjë të huaj,  
botës së vjetër varrin bashkë ia grryejnë.

11 Qershori përshëndet  
i mijrasylynjarti krua  
i zemrës popullore,  
një popull mbarë — krijues e luftëtar,  
që gur të çmuar quan emrin  
Grua.

## **SONETET E PROTESTËS**

### **I**

Më joshte mbrëmë nga pyjet larg bilbili,  
në Hekurudhë më ftonte mbrëmë rinia...  
Por më trishtoi fjala tragjike KILI,  
urrejtja vloi nga fjalët JUNTE e CIA.

Mbi njerëz sulen me etje prej katili,  
ndër pranga duan të lëngojë liria.  
Këtë varg e shkroi i gjakut t'kuq currili.  
Protesta u ngrit si dallgë nga thellësia.

Me dhunë, me raprezalje e helmatisje,  
me pushkatime, burgje dhe bastisje  
një popull kurrrë nuk mund të qitet fare!

Popull i Kilit, popujt me ty janë!  
Me ju jem', revolucionarë kilianë,  
me ju është Shqipëria luftëtare!

## II

Gratë ndër fabrika thrrasin: — Sot qefine  
endim pér ju, fashistë, ndër avlëmende.

— Ne s'mund ta lemë Atdheun buzë gremine! —  
betohen minatorët ndër kuvende.

Liri kërkojmë në Amerikë Latine,  
ndaj fluturojmë të lirë në krahë legjende.  
Do i llahtarisë tiranët stinë pas stine  
betimi ynë, martiri i ri Alende.

Nga gjaku i presidentit Salvador  
Alende, gjaku i popullit punëtor,  
liria e shkelur prap do lulëzojë!

Liria s'vjen me anë të një fletushke  
revizionistësh... Grykë e flakët pushke,  
prej teje del ajo — me këngë në gojë!

## S F I D E

Në popull — frysëzimet,  
tingujt,  
ritmet,  
në popull — heroizmi dhe virtytet,  
~~epika e sotme, të së ardhmes bitmet,~~  
liria brez pas brezi dalë prej tytet.  
Mbi male shkruar — sfida jonë shqiptare.  
Në gojë të popullit — thirrja krenare.  
Në dorë — hosteni...

Armiq!  
Pelin ndër vargje do të gjeni!

Ju, zotërinj e neozotërinj,  
ju, krokodilë,  
hiena,  
ujqër,  
minj.

edhe sikur çelik të breni,  
në tokën tonë disfatë e varre keni!

Kur fitimtarë ne çojmë përmes shtërgatës  
pishtarin e së drejtës,  
të lirisë,

me kohë ju tatëpjetën keni nisë,  
ju — pjella e mesnatës  
së historisë...

Oh, thellë në mish ju përcëllon hosteni!  
Ndaj me tërbim mbi ne ju dufin shfreni,  
gangsterë e cuba e kalemxhinj ndërseni,  
me dhëmbë tinzarë në heshtje nâtën breni.

Ju varret i rrëmoni,  
që të ngreni  
kufomat prap në këmbë, —  
më kot e keni!

Më kot orvateni  
në grykë  
uiski e vodka të na rrëkëlleni.  
pastaj hipokrizisht t'na merrni ngrykë!...

Atdheun ne ndërtojmë krenarë,  
të lirë.

Fort mirë  
ju peshën e urejtjes sonë e ndieni.

S'ju merr (të gjorët ju!) ky gjumi i natës,  
ju turbullon  
niveli ynë «mediokër»...

Vërtet

ne grurin mbledhim n'arë kokërr për kokërr,  
ndodh që gjer vonë n'uzinë punojmë vërtet,  
por ballin ne si malet mbajmë përpjetë  
e ngrihem i përherë për ju  
gjykatës.

Me joshje dhe pretime s'na gënjeni  
dhe s'jua ndal thumbimin kurrë  
hosteni.

Me soldat tuaja

ju dot s'na ktheni

nga rruga e vëشتirë që e zgjodhëm vetë,  
nga rruga e lavdisë që rron përjetë.

Kjo dora juaj — dorë përbindshi zhvatës.

Ky zëri juaj — zë prej minjsh, ciatës.

Ju — plehranikë, të krimit rrögëtarë,

tregtarë flamurësh,

firmëtarë

traktatesh hileqare...

Po, gjumin tua trazon sfida shqiptare!

Si tepër shpejt po pini e po dëfreni,  
daullet po i rrihni çakërdisë...

Ju shtireni.

Ju dëshpërimin s'doni ta dëfteni  
që në stacion të historisë  
ju ka braktisur treni.

Ju jetën tuaj pa lavdi e çoni  
në soldën e superfuqive,  
ju — tradhëtorët e revolucionit,  
atentatorët e lirive,  
shkaktarë mjerimesh,  
lotësh,  
kampionë dredhirash e komplotesh,  
mënyrash prapaperdesh,  
prapashtinash...

Një fund do keni ju — mes hedhurinash!

Ti ngjitu prap në vargjet-shkallë, Poet!  
Më ne radhitutti  
në luftë,  
në art!  
Shqiptarët sot kanë krenarinë e vet,  
për reaksionin azembanë — tërmët,  
borgjëzë e renegatë ne i vrejmë  
nga lart!!)

1) Perifrazim i vargjeve të Majakovskit.

Një grusht të vetëm shpartallues ne kemi.

Ne jemi

një repart.

Pishtar të ndritshëm mbajmë në duar.

Eshtë fjala jonë — jo e mektë e fantaziste.

Gjithmonë është e ndriçuar

nga prozhektori i ideve komuniste.

Një — thirrja jonë:

«Liri!

Revolucion!»

Një — këngë plot shëndet e një — refreni.

Gjithmonë

me thumb të mprehtë armiqtë i shpoftë hosteni!

Sot eja edhe ti me ne, Daj Ceni!

Eja me ne

të thurim bashkë një «epope» të re!

Eja ku vërshëllen i lumtur treni,

ku dielli lind e feks argjend liqeni,

ku majëskuqur ndrit përherë hosteni!

Mbi ju,

armiq,



me thundrën-hekur shklas,  
nga syri, dredharakë, nuk ju humbas....

Këtë sfidë  
mu në fytyrë po ju përplas.

## **POEZIA DERDHET BASHKË ME MINERAL**

Si n'oqean detarin, rrahë prej erës,  
nën tokë punëtorin sulmi e kalit.  
Në galerinë e errët të minierës  
ndërgjegjja e re përftohet forcë-e-dritë.

Në galerinë e dashur të minierës  
ai hyn si n'korridorin e shtëpisë,  
kur është mesnatë e në shtëpi ka njerëz  
dhe faqen shkon t'i puthë në gjumë fëmisië.

Gjëmon sot galeria prej poterës,  
kur trimat tanë gërryejnë t'ashprin mal.  
Në galerinë diellore të minierës  
poezia derdhet bashkë me mineral.

## **KENGË QE S'PERËNDON**

Ne bashkë shtrojmë shina e mbërthejmë traversa,  
n'agim mbi ballë na ndrit si vesa djersa.

Në punë e jetë — të rrrokur dorë për dore.  
Të lirë dhe zjarr — në vallet popullore.

Rinohet kënga ardhë nga lashtësia.  
Një këngë që s'perëndon gjithmonë rinia.

Kjo ditë e re ne zemrat na i ndezi,  
ne këngë e ritme shpiem brez pas brezi.

Përherë mbi ballë n'agim t'na ndrisi djersa!  
Drejt Komunizmit t'i mbërthejmë traversat!

### **DIKUSH TROKET. . .**

Dikush troket në portë të zemrës sime.  
N'qoftë se je ti, o dashuri e vërtetë,  
ti mirseardhsh,  
te unë ke për të gjetë  
një ndjenjë të zjarrtë, që rron përjetë.

Ti, dashuri, në qofsh një fillad pranvere,  
në qoftë se këngë e pambarim ti je,  
ti mirseardhsh,  
në zemrën time ke  
fillad pranveror, një këngë të re.

Dikush troket në portë të zemrës sime.  
Hyr, dashuri!... Në ardhsh si një furtunë,  
ti mirseardhsh!  
Do jemi, ti dhe unë,  
furtunë e dallgë në jetë e punë.

## **LE TË NGULEN STROFAT SI PERONA!**

Jeta e re n'uzina e male ndrit.  
Për njeriun e ri — gjithë këngët tona!  
Mbi rrufjanë, mashtrues, kozmopolitë  
le të ngulen strofat si perona!

Midis katër muresh, ulë n'karrike,  
me llambë elektrike përmbi kokë  
rrinte e shpikte dritën elektrike,  
veten e mendonte diell mbi tokë.

Nëpër kafenera duke llapë,  
duke dhënë bekime e mallkime,  
ai vetveten e pandehte papë,  
kokë të ndritur, që përhap shkëlqime.

Mizë zukaste përmbi buajt e mirë,  
që tërhiqnin qerren plot me drithë,

dhe e kujtonte miza e pështirë  
më të aftë vetveten se të gjithë.

Thurte intriga mu në mes të natës,  
ditën dilte me një tjetër faqe.  
Ëndërronte veten shef, gjykatës,  
mblidhte rreth servilë edhe handraqe.

Që nga këndi i errtë i mikrobotës  
rruga e ndritur i gjasonte hon...  
Dhe harronte krejt mikrobi ndotës:  
flaka jonë mikrobet përcëllon.

Klima jonë përzë çdo rrufë të huaj:  
Kurrë borgjeztë, hiletë revizioniste  
ne në gjumë s'na gjejnë tek mbledhim duaj,  
kombinate ngrejmë, këngë komuniste.

Të moshuarit edhe të rinjtë  
ecim tok me shpejtësinë e trenit.  
Mendjeshkurtërit e batakçinjtë  
i mbërthejmë në majën e hostenit.

Sy të mprehtë ne kemi e të vëmendshëm,  
jemi ne një mur i jashtzakontë.

Çdo armik, i jashtäm a i brendshäm,  
kokën thyen n'murin e betontë.

Çdo rrufjan nga rrufa e huaj ngjirë  
le ta dijë: kurrë zëri ynë s'venitet,  
ne Revolucioni na ka thirrë,  
n'zjarr të tij çeliku ynë kalitet.

Mbi rrufjanë, mashtrues, kozmopolitë  
le të ngulen strofat si perona!  
Jeta e re ndër këngë e mendje ndrit.  
Për njeriun e ri — gjithë këngët 'tona!

## **AS NDËR DOLLI . .**

Thith gjak, fitimet që të jenë të majme,  
në çdo gasti dollinë e ngre me gjak  
dhe të mashtron, të ngop e vel me lajme  
sensacionale, të servir farmak.

S'jetojmë ne pranë moçaleve si çajme,  
thellë në moçal fundosim çdo dinak.  
Dollia jonë: — Në botën e pastajme  
kurrë mos sundoftë më ligji shtazarak!

Kot kthetrat fsheh, lubi imperialiste!  
Të njohim mirë, dredhi revizioniste!  
Prandaj ne s'ju harrojmë as ndër dolli.

Për festën tonë shpërthejnë sot fishekzjarret  
dhe hap pér ju vetë Historia varret, —  
një lak më shumë në qafë — çdo vit i ri.

## **ME NE TI EJA!**

Humbur në rrjetën e aq mashtrimeve,  
njeriun sheh ti në rrjedhë të shekujve  
një lodër në dorën e fatit...  
Zgjohu e shih kush mbi supe e mban botën!

Të dehin dritat e shumëngjyrshme,  
kërcimet — t'egra e marramendëse,  
mendimi çapitet i plogët...  
Shkundu, pra, dhe shpalose ti zemrën!

Të shndrrojnë në vegël, n'ushqim të topave,  
të bëjnë zjarrfikës t'revolucioneve,  
t'gjymtojnë si njeri dhe të flakin...  
Kundërshto këtë manevr tragjike!

Se vjen vëtmia, trishtimi i pritjeve,  
monotonia e trishtë e fjalëve,

që vetëm përsriten, zvariten...  
Jakë me ne, të shpërthejmë si vullkanet!

Me ne ti eja! T'u vëmë zjarr minave!  
Me forcë viganësh t'u biem prangave!  
Të kuq po valviten flamurët.  
Komunizmi — e ardhmja e botës.

## NË KËTË BREGDET

### I

Ç'më zhyt ky det i gjerë mes brohorisë,  
sa gaz më ndez hareja e një vocrraku!...  
Por, mbrëmjes, mitralozi krismat nis  
dhe detin e mbulon krejt ngjyra e gjakut.

Pikon ky gjak mbi varg të poeziსë,  
i shenjtë ndër mote gjaku i Ulqinakut,  
që mbeti në këtë breg të Shqipërisë  
faqen përjetë mbështetur pas kondakut.

Gjergji i rri pranë, dalë nga legjenda e moçme.  
Pranë — trimat partizanë. N'ushtrinë e soçme  
i gjallë mes nesh qëndron Dëshmori i Parë.

Balozi, po të dojë me dalë prej ujit,  
duhet të matet me fuqinë e Mujit,  
me ushtrinë e rreptë të popullit shqiptar.

## II

Dhe ra atë ditë edhe Dëshmori i Fundit.  
Ishte Njëzetenëta e Nëntorit.  
Sa mirë këndoi rapsodi i katundit  
dhe shtinë batare shokët e dëshmorit,

shokët e varfërisë edhe të mundit,  
shokët e sulmit kundër agresorit!  
Çdo këngë e re si djep do ta përkundi,  
do ta gëdhendë ringjal'ë dora e skulptorit.

Sa shokë na u vranë... S'na mbyti vaji e tënga!  
Se mbi çdo kob u ngrit krenare kënga,  
na i ngriti zemrat lart kjo krenari.

Oh, kur na puthnin nënët trimëresha —  
reçjane a pezake a labëresha —  
në ballë na puthte mëma Shqipëri!

## III

Ajër malesh thithim, ajër nga i kaltri det.  
Kjo jetë e re për nje është fllad këndellës.  
Revolucionin dimë ta ruajmë vetë,  
mina s'lejojmë nën muret e kështjellës.

Punojmë gjer vonë e veten ndiejmë tē qetë.  
Në djall pagjumësi e gjumëndjellës!  
Nuk e çojmë jetën ndër jastëkë mbështetë  
prej pijes marrakotë e velë prej gjellës.

Me erën e furtunën — ballë pér ballë.  
Si t'parët tanë dyfekun me stërrall,  
ne gati mbajmë sot armët më tē reja.

Armë — topi e tanku, jugu dhe veriu,  
armë — kazma, pena — armë — njeriu,  
pérhera ngadhnjimtari ndër beteja.

#### IV

Ne s'do humbasim nëpér kotësira.  
Në mendje sjellim nëpér shekuj vojtjen,  
bimë edhe njerëz vyshkë nga thatësira.  
Pa Socializmin nuk e duam rrojtjen.

Kujtojmë bejlerë, borgjezë, zaptues, zinxhira...  
Dhe tej si leckë tē ndyrë e flakim drojtjen.  
Ne s'i harrojmë superfuqitë lubira,  
na frymëzon via e Partisë pér mbrojtjen.

Në këtë bregdet të rrallë e të mahnitshëm  
nuk shkel dot kurrë armiku i neveritshëm,  
se roje rri çdo breg edhe çdo çukë,

se ushtria prej çeliku është e bërë,  
se s'lyp gjë tjetër populli i tërë  
veçse Partinë në ballë, armë e ca bukë.

## V

Atje ku plumbi i Mujos fishkëllonte,  
unë po këndoja i lirë me zërin plot.  
Në këtë bregdet shëtis i lumtur sonte,  
por strofat rri e i mbushi me barot.

Çdo re të zezë hetojmë ndër horizonte.  
Nga ky bregdet, armiq, s'na shkulni dot!  
Sulmon Atdheu në të gjitha frontet.  
Ky vend i mrekullueshëm, shokë, ka zot.

Ky vend ka Komandantin e Përgjithshëm.  
Në Republikn' e re është i pazgjidhshëm  
bashkimi popull e parti e pushtet.

Sepse, pas ligjërimesh e rënkimesh,  
mërgimesh e betejash e zaptimesh,  
për lumturinë sot dallga e detit flet.

## **SYTË E NAIMIT**

*Duke vizituar shtëpinë-muze  
të Tre Vëllezërve të mëdhenj  
Naim, Sami e Abdyl Frashëri.*

### **1**

Tek Tre Vëllezërit sot ishim miq.

Tre burra,  
tre viganë  
rreshtuar pranë e pranë,  
tri maja të vargmalit,  
tri flakë të idealit,  
që nëpër mote kurrë nuk vdiq.

Tek Tre Vëllezërit sot ishim miq.

### **2**

Unë nga konaku rimëkëmbë në Frashër —  
për gjithë një popull sihariq —  
u ktheva fill në rrugëzën e varfër

të Shkodrës,  
ku Poeti fluturoi  
sa të shikonte Drin edhe Bujanë...

Porse në dhomë përherë më ndenji pranë.

Qëndronim ballë për ballë.  
Nga muri  
Poeti kuvendonte si i gjallë  
me mua — djaloshin zemërvalë.  
M'i ngulte sytë  
e gjuha s'mbetej belbër,  
çdo dru i tharë më bëhej fill i gjelbër.  
Ai zuri vend ndër zemrat njerëzore.  
Ai flakëroi ndër traktet e Partisë.  
U lind në malësinë e Dangëllisë,  
jetoi  
në çdo vis të Shqipërisë  
bilbil i tokës arbërore.

### 3

Të rind.  
Por kohë nuk kishim për endirë,  
nuk jepeshim pas lodrës  
së fantazive t'ëmbla fëminore.

Ne shfrenim kundër tiranisë mizore.

Në atë shtëpizë të Shkodrës  
në letër dylli  
godisja shkronjat gjer në të gëdhirë.  
Në terr të natës  
prej pesëcepash më shkëlqente ylli,  
pushtohesha nga forca e shtërgatës  
së kryengritjes popullore.  
Në atë shtëpizë  
më nxiste në çdo provë të vjershërimit  
vështrimi i frysmauar i Naimit.

Fashizëm.  
Tradheti e robëri.  
Atdheu — buzë një honi...  
Populli ynë të priste ty, Parti,  
që armiqtë përdhe t'i shembte me rrufe.  
Revolucioni  
do i sillte Atdheut një agim të ri  
dhe syve të Poetit flakë të re.

4

Përleshja ish e egër dhe e vështirë.  
Burgje e tortura, në çdo hap — pusitë.  
Unë llambën ndizja.  
Në gjysmë-errësirë

më ndrisnin sytë e dashur të Poetit,  
thërrisja bashkë me zërin e Poetit:  
— Tani lipsetë dritë!  
Tani lipsetë dritë!

Vërshonin si nga thellësitë e detit  
kujtimet e lavdive,  
zemrën rinore  
ma ndiznin farkëtuesit e lirive,  
më e shtrenjtë më bëhej toka arbërore,  
në shpirt më lindnin  
për një jetë  
motive.

## 5

Në Frashër  
më shumë se kurrë Naimin pata afër.

## 6

Shqiptari  
me malet veten ndien të barabartë.

Duke u ngjitur në atë vend të lartë,  
duke u mahnitur nga agimi i artë,

duke vështruar Arbërinë,  
kuptova pse Poeti shkroi në kartë  
se nuk u mposht shqiptari kurrë,  
se nëpër shekuj pati  
lartësinë.

Shqiptari nuk u mposht  
nga okupatorë e nga tradhtorë,  
nga Ballë e Bosht.  
S'u mposht edhe nuk do të mposhtet kurrë.  
Gjithmonë do pijë në gjallëruesen gurrë.

7

Kaluan partizanët  
edhe panë —  
shtëpia s'kishte mbetur as gërmadhë!  
Te guri i vetëm ata u vunë në radhë  
dhe thanë:  
— Këtu sot le të mbillen tre fidanë!  
Dhe emrin e Naimit,  
që lart e ngriti Shqipërinë,  
që shkroi për bagëtinë e bujqësinë,  
që thuri historinë e Skënderbe kryetimit,  
me gjak të kuq ta shkruajmë në flamur!  
Ta ngremë flamurin, shokë, mbi shkëmb e  
gur.

sot Shqipëria pret prej nesh lirinë,  
ditët e mira, shokë,  
paskëtaj vinë!

Dhe ashtu bënë.  
U hodh në sulme çeta,  
u hodh në sulme Shqipëria mbarë...

Kudo përmbi gërmadha lindijeta.

Dhe sihariqi u përhap:  
— Këtu, në Frashër,  
populli shqiptar  
shtëpinë përmbi themele ngriti prap,  
ngriti muzenë  
për burrat që nderuan mëmëdhenë,  
që brezat  
gurrë  
përherë ta kenë!

### 3

Sërish rrimë me Poetin ballë për ballë...

Unë tanimë s'jam djalë,  
por zemrën kam në kraharor të valë.

Prap sytë Naimi sot m'i ngul.  
Dhe guha s'mbetet belbër...  
Marsho, Atdhe, -  
përherë i lirë dhe i gjelbër!

## O REPUBLIKE E HEKURT!

hymn

Ky vend i lashtë e i rreptë i heroizmit  
sa malet ngriti lart lavdinë e re.  
Valon Flamuri i Kuq i Komunizmit,  
shqiponjat tona fluturojnë mbi re.

Si sytë të mbrojnë punëtorët dhe fshatarët, o Republikë, mbi gjak dëshmorësh ngritë. Në punë edhe në luftë vrapojmë të parët, të ngrejmë kështjellë, që s'pyet për stuhitë.

Marshon, marshon përpara Shqipëria e rritet krenaria, forca jonë, drejt majash e thërret gjithmonë Partia dhe kazmë e pushkë shtërngon në dorë gjithmonë.

Çka shekujt nuk krijuan ti krijove,  
o Republikë e popullit shqiptar.

Ne të bashkuar i bëjmë ballë çdo prove,  
kërkojmë përherë lirinë e botës mbarë.

O Republikë e hekurt,  
je  
kushtrim i zjarrtë për Botë të Re.  
O Republikë, kështjellë shqiptare,  
mbi çdo armik del fitimtare,  
ti proletare përjetë qëndron,  
trumbetë për sulme,  
Revolucion.

## JU FLET TIRANA!

Eshtë festë.

1 Maj.

Thirrje të zjarrta, vargje e melodi  
derdhen si dallgë me bujë e brohori...

Tirana

flet,

në gjithë Atdheun hapet zëri i saj:  
«Gëzuar, shokë!

Eshtë festa jonë 1 Maj!»

Ndër kontinente zëri fluturon,  
zëri i ngadhnjesit Revolucion:

«Këndoni, shokë, me ne!

Internacionale

do jetë Bota e Re!»

«Ju flet Tirana!»...

Flet

Tirana jonë.

Ky zë

në globin mbarë sot bën jehonë.

Flet

Tirana e Shtabit të Partisë së Punës,  
Tirana e flladit,  
e furtunës.

Ju flet

Tirana e 8 Nëntorit të lavdishëm,  
Tirana e Enver Hoxhës themelues,  
Tirana e sulmit të stuhishëm,  
e shpirtit proletar sulmues,  
Tirana e barrikadave,  
e flamurit të kuq në krye të Brigadave.

Ju flet

Tirana ngadhnjimtare ndër beteja,  
Tirana e uzinave të reja,  
e universitetit,  
e dritës dhe e shëndetit,  
Tirana e sheshit «Skënderbe»,  
që vlon ndër festat tona me hare,  
Tirana,  
që marshon më shpejt se kohët,  
Tirana e re,  
që për çdo vit rinohet.

### Ju flet

Tirana e miqësisë që kurrë s'venitet,  
e sofrës sonë bujare,  
e besës sonë shqiptare,  
Tirana — dritë që s'do ta shuajnë vitet.  
Tirana e kuqe revolucionare  
e Internacionalet Proletar,  
Tirana e lavdisë së re shqiptare.

Kur flet Tirana,  
moti çel i qeshur,  
ngrihen të vegjël edhe të mëdhenj,  
nënshtrohet inondaçë edhe tërmët  
e njomet buza që ka et,  
n'aksiون vrapojnë të rinxjtë për t'u përleshur  
me të paepurit shkëmbenj,  
vrapojnë dhe flokëtinjurit llërëpërveshur,  
nga rruga s'i dredhojnë dinaket joshje,  
këndojujnë:  
— Ti, Shqipëri, po të na thoshje  
«tok derdhni gjakun»,  
gjakun derdhim ne  
si djersën tok ë derdhim sot rrëke!

Kur flet Tirana,  
fluturimi ynë

bëhet më i lehtë e flladi ëmbël fryn.  
Çdo ëndërrim për ty, Atdhe,  
si shtegëtimi i zogjve — i pandalshëm,  
me ty — në hidhërim e në hare  
dhe çdo largim prej teje — i pafalshëm!

Qëndron Atdheu ynë — kështjellë,  
rrënjet — në tokën gjakvaditur thellë,  
flamurët — gjer në qiej,  
edhe në qiell të natës — qindra diej.  
Qëndron.

Përplasen dallgë të çakërdisura,  
vêrsulen,  
shkumëzojnë  
si gojë të jargavitura,  
që shpifin e mallkojnë e kërcënojnë...

Një këngë ndër kraharorë sot na buçet.  
Eshtë festë.

1 Maj.

Tirana flet,

në gjithë Atdheun hapet zëri i saj.  
Ndër kontinente zëri fluturon,  
zëri i ngadhnjyesit Revolucion.  
Lëviz kjo Rrotë e Historisë —  
e rëndë,  
e gjithpushtetshme,

superfuqira e demagogë gremis....  
Me aradhe të shëndetshme  
ngrihet,  
do ngrihet klasa punëtore  
me forcën viganore  
të një difi,  
që i zhvendos dhe malet.  
S'është Rrota e Historisë guri i Sizifit, —  
ajo lëviz  
e s'ndalet!  
Gjëmon zëri i Tiranës tejetej:  
«Hej!  
Ne gjaku i kuq, o shokë, na vlon ndër dej!  
Flamurët e 1 Majit — gjer në qiej!  
Edhe në qiellos të natës — qindra diej!»

«Ju flet Tirana!»...  
Flet  
Tirana jonë.  
Ky zë  
në globin mbarë sot bën jehonë,  
ky zë —  
rrebesch për shtypës e padronë,  
kamzhik për hileqarë,  
ky zë  
është këngë e lirë edhe kushtrim,  
për ndeshje e për fitore — frymëzim.

Ju flet  
Tirana,  
i së vërtetës kryeqytet.  
Kur flet Tirana,  
Shqipëria  
flet.